

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**  
**Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara**  
**Fushata zgjedhore 2011**  
**Periudha 8/04/2011 - 8/05/2011**

---

### **Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Unë kam audituar pasqyrën (deklaraten) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzimeve për fushatën zgjedhore të Partisë "MENDIMI I DJATHTË LIBERAL", për periudhën 8/04/2011 deri më 8/05/2011.

Paqyra është përgjegjësi e drejtimit të subjektit zgjedhor, Partia "Mendimi i Djathtë Liberal"

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia bazuar në librin e llogarive dhe të regjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjithë transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtimit-pagesave. (deklaratës)

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, në referencë të vecantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta-auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike" Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj dhe të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyra financiare e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të mos përmbajë anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrën bashkëlidhur. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit dhe përfshijnë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrës përkatëse, qoftë për shkak të mashtrimit, ashtu dhe të gabimit. Për vlerësimin e këtyre rreziqeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të Partisë që ka të bëjë me përgatitjen e pasqyrës me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të saj. Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrën financiare, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura, të vlerësimeve të rëndësishme të bëra nga Partia, si dhe një vlerësim të paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor, Partisë "Mendimi i Djathtë Liberal", është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Subjekti deklaron se nuk ka përfituar asnjë fond dhe nuk ka bërë shpenzime.

Për mendimin tim, pasqyra (deklarata) bashkëlidhur e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore e Partisë "Mendimi i Djathtë Liberal" e datës 8.05.2011, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave , konform me ligjin nr 9228 datë 29/04/2004 i ndryshuar ' Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

Pa modifikuar opinionin tim , tërheq vëmendjen se Subjekti duhet të tregojë kujdes, në lidhje me vërtetimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve të kryera (kur ka) me dokumente justifikues sipas kërkesave të ligjeve fiskale (tatimore), të kërkuar nga ligji "Kodi zgjedhor i RSH" nen 90 , paragrafi 3 i tij.

**EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR**

MIRA KASTRATI SYKJA  
EKSPERTE KONTABEL  
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)  
AUTORIZUAR  
SHKODER

Tiranë, më 25 janar 2012

Adresa:

Rr . "Perlat Rexhepi"

Nd 10, Hyrja 27, Ap 10

Kodi Postar 1019

Tiranë

Mob: 0692086610

Home: 042261811